



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 659/prot.
3

Tiranë, më 22.09 2026

NJOFTIM

**PËR ZHVILLIMIN E AUDICIONIT PËR POZICIONIN E LIRË TË PUNËS
“VALLTAR I KATEGORISË SË DYTË” PRANË DREJTORISË ARTISTIKE TË
ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE**

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar me urdhrin nr. 187, datë 04.07.2014 dhe nr. 148, datë 11.09.2026, Statutit të TKOBAP-së të miratuar me urdhrin e Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015, Rregullores së brendshme nr. 1143 prot., datë 21.11.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” si dhe në çdo dispozite tjetër ligjore në fuqi për aq sa është e zbatueshme, shpall audicionin për pozicionin e lirë të punës “Valltar i Kategorisë së Dytë” pranë Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë dhe përgjegjësitë/detyrat kryesore të “Valltarit të Kategorisë së Dytë” pranë Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore:

1. Të ketë përfunduar minimalisht arsimin e mesëm të lartë të orientuar në balet.
2. Të jetë i aftë për të punuar në një mjedis dinamik pune, të marrë përsipër të respektojë orarin dhe planin e punës që do të vihet nga TKOBAP-ja dhe të ketë aftësi të organizojë punën në ngarkim me efikasitet, efektivitet, efikasitet dhe sipas afateve të përcaktuara.
3. Të marrë pjesë, kur kjo i kërkohet nga institucioni në kuadër të projektit “Edukimi përmes kulturës”, në procesin e edukimit që zhvillohet në shkolla, auditore etj., sipas një plani të përgatitur nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe TKOBAP-ja.
4. Të marrë pjesë në të gjitha provat në studio dhe në skenë dhe të angazhohet seriozisht në përgatitjen e shfaqjeve (premiera apo repertor të TKOBAP-së) brenda e jashtë skenave të tij. Nëse nuk është pjesë e një produksioni të caktuar, duhet të jetë në dispozicion të shfaqjeve të ardhshme me vepra të përgatitura gjatë provave.
5. Të respektojë disiplinën artistike dhe skenike në cilësinë e kërkuar.
6. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrim (CV);
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit;
4. Diploma dhe lista e notave të noterizuara. Në rast se arsimimi është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë (në mungesë të përkohshme të saj vërtetimin e qenies në proces njohjeje);
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit;
6. Libreza e punës e noterizuar dhe vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH-ja (nëse ka);
7. Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit);
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vërtetim i aftë për punë).

Të gjithë ata artistë të brendshëm të interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë vetëm një letër shprehje interesi për pozicionin e lirë të punës.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 19.10.2026 me objekt: “Aplikim për audicionin për pozicionin e punës “Valltar i Kategorisë së Dytë” pranë Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore”.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Programi për konkurimin:

I. PROGRAMI I KONKURIMIT PERSONAL

Çdo konkurent do t'i nënshtrohet pjesës së konkurimit personal e cila do të përfshijë:

1. Ushtrime të teknikës klasike

- Ushtrime në levë;
- Ushtrime në qendër të sallës;
- Ushtrime të përshtatura me nivelin dhe kategorinë për të cilën zhvillohet konkurimi.

Kjo pjesë e programit do të shërbejë për vlerësimin e teknikës, koordinimit, ekuilibrit, fleksibilitetit, forcës dhe kontrollit trupor të konkurentit.

2. Riprodhimi i një motivi koreografik me shikim të parë

Konkurentit do t'i demonstrohet një motiv koreografik të cilin ai/ajo duhet ta riprodhojë pas një periudhe të shkurtër vëzhgimi.

Kjo pjesë e programit do të vlerësojë aftësinë për të perceptuar dhe memorizuar shpejt lëvizjen, koordinimin, ritmin, muzikalitetin dhe reagimin ndaj udhëzimeve koreografike.

3. Demonstrimi i një valleje popullore të përzgjedhur nga konkurenti

Çdo konkurent do të paraqesë një valle popullore shqiptare të përzgjedhur prej tij/saj me kohëzgjatje **minimale 1 (një) minutë dhe maksimale 2 (dy) minuta e 30 (tridhjetë) sekonda.**

Vallja duhet të demonstrojë nivelin teknik dhe interpretues të konkurentit dhe konkurenti duhet të jetë në gjendje të shfaqë karakterin, stilin, ritmin dhe veçoritë e traditës së zonës së përzgjedhur.

4. Demonstrimi i motiveve popullore shqiptare

Konkurenti duhet të demonstrojë aftësi në ekzekutimin e motiveve karakteristike të:

- **Jugut të Shqipërisë;**
- **Veriut të Shqipërisë;**
- **Shqipërisë së Mesme.**

Kjo pjesë e programit ka për qëllim vlerësimin e aftësisë së konkurentit për të përvetësuar dhe interpretuar stile të ndryshme të traditës koreografike shqiptare.

II. DEMONSTRIMI I DETYRUESHËM PËR ÇDO KONKURENT

Përveç konkurimit personal, çdo konkurent do të jetë i detyruar të demonstrojë elementët koreografikë të përcaktuar më poshtë, të cilët konsiderohen pjesë e domosdoshme e vlerësimit profesional për pozicionin e punës.

1. Finalja e valles “Në Garë” – në çift

Kjo pjesë do të zhvillohet në çift dhe do të shërbejë për vlerësimin e:

- aftësisë komunikuese me partnerin/partneren;
- koordinimit dhe sinkronizimit në çift;
- ndërveprimet dhe bashkëpunimit koreografik;
- përshtatjes me partnerin/partneren;
- aftësisë për të ruajtur fokusin dhe përqendrimin;
- nivelit teknik në ekzekutimin e elementeve të vështira të kësaj valleje.

2. Finalja e valles “Barinjtë e Korabit” – vetëm për konkurentët meshkuj

Kjo pjesë do të jetë e detyrueshme për konkurentët meshkuj dhe do të përdoret për vlerësimin e aftësive teknike, fizike, ritmike dhe interpretuese të kërkuara nga kjo valle.

3. Finalja e “Valles së Tropojës” – vetëm për konkurentet femra

Kjo pjesë do të jetë e detyrueshme për konkurentet femra dhe do të përdoret për vlerësimin e teknikës, elegancës, koordinimit, ritmit dhe karakterit interpretues të kërkuar nga kjo valle.

III. TRAJNIMI PËR VALLET E DETYRUARA

Për sa i përket valleve të detyruara të përcaktuara në programin e audicionit, çdo konkurent ka mundësinë të përgatitet paraprakisht pranë stafit profesional të valleve të Ansamblit Popullor.

Për këtë qëllim, konkurentët mund të paraqiten për trajnim pranë stafit të valleve të Ansamblit Popullor vetëm me kërkesë të tyre (të depozituar me ose pas depozitimit të dokumentacionit të listuar në këtë njoftim) dhe pas marrjes së përgjigjes nga institucioni, gjithmonë përpara zhvillimit të audicionit.

Trajnimi do të konsistojë në njohjen dhe përgatitjen e materialeve koreografike të valleve të përcaktuara si të detyrueshme në programin e konkurimit dhe synon të garantojë që të gjithë konkurentët të kenë akses në materialin koreografik dhe mundësi të barabarta për përgatitje përpara vlerësimit.

Programi i konkurimit është hartuar duke marrë në konsideratë natyrën specifike të veprimtarisë artistike të Ansamblit Popullor dhe nevojën për të përzgjedhur kandidatë që, përveç përgatitjes së përgjithshme fizike dhe klasike, zotërojnë:

- teknikën e valles;
- muzikalitetin dhe ndjeshmërinë ritmike;
- aftësinë për të mësuar dhe riprodhuar shpejt materiale koreografike;
- njohjen dhe interpretimin e motiveve të ndryshme të folklorit koreografik shqiptar;
- aftësinë për të punuar në çift dhe në grup;
- karakterin dhe ekspresivitetin skenik;
- disiplinën dhe përgatitjen profesionale të nevojshme për të qenë pjesë e Ansamblit Popullor.

Audicioni do të zhvillohet në datën 26.10.2026, duke filluar nga ora 13:00, në Sallën e Sektorit të Valleve të Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Shënime:

1. Komisioni ruan të drejtën të kërkojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.
2. Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet postës elektronike zyrtare për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.
3. Për çdo pyetje lidhur me zhvillimin e audicionit mund t'i drejtoheni adresës në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aulon Naci

